FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.8 — 21 shkurt — 2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 2/2012 datë 26.1.2012	Për disa ndryshime në ligjin nr. 8951, datë 10.10.2002 "Për numrin e identitetit të shtetasve"	325
Ligj nr. 3/2012 datë 26.1.2012	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.5, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në ligjin nr.10 418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor""	326
Ligj nr. 4/2012 datë 2.2.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në ndryshimet e konventës për krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor, bërë në Bruksel më 15 dhjetor 1950	326
Ligj nr. 5/2012 datë 2.2.2012	Për ratifikimin e protokollit të privilegjeve dhe imuniteteve të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore	329
Ligj nr. 6/2012 datë 2.2.2012	Për një ndryshim në ligjin nr.10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile"	338
Vendim i Kuvendit nr. 1/2012 datë 26.1.2012	Për numërtimin e ligjeve dhe vendimeve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë	339
Vendim i Kuvendit nr. 2/2012 datë 26.1.2012	Për ngritjen e Komisionit Hetimor dhe caktimin e objektit, përbërjes dhe afatit të Komisionit Hetimor për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të zotit Kreshnik Spahiu, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë.....	340
Vendim i Kuvendit nr. 3/2012 datë 26.1.2012	Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr.3, datë 16.9.2009 "Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar.....	341

Vendim i Kuvendit nr. 4/2012 datë 2.2.2012	Për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Taulant Balla.....	341
Vendim i Kuvendit nr. 5/2012 datë 2.2.2012	Për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Tom Doshi.....	342
Vendim i Kuvendit nr. 6/2012 datë 2.2.2012	Për dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Besnik Baraj.....	342
Vendim i Kuvendit nr. 7/2012 datë 2.2.2012	Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës.....	343
Vendim i Kuvendit nr. 8/2012 datë 2.2.2012	Për emërimin e një anëtari të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE).....	346
Vendim i Kuvendit nr. 9/2012 datë 16.2.2012	Për shtyrjen e afatit të veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit "Për ngritjen e komisionit hetimor dhe caktimin e objektit, përbërjes dhe afatit të komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të zotit Kreshnik Spahiu, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 2/2012, datë 26.1.2012.....	347
Vendim i Kuvendit nr. 10/2012 datë 16.2.2012	Për lirimin e zonjës Enkeleda Shehi nga detyra e Nënkryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në pozicionin drejtues i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit dhe zgjedhjen e saj në detyrën e Kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare	347
Vendim i Kuvendit nr. 11/2012 datë 16.2.2012	Për zgjedhjen e zotit Mati Pepa anëtar të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në pozicionin Nënkryetar, drejtues i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit	348

LIGJ
Nr. 2/2012

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8951, DATË 10.10.2002 "PËR NUMRIN E IDENTITETIT TË SHTETASVE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8951, datë 10.10.2002 "Për numrin e identitetit të shtetasve" bëhen këto ndryshime:

Neni 1

1. Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:
"Për numrin personal të shtetasve".
2. Kudo në ligj fjalët "numri i identitetit" zëvendësohen me fjalët "numri personal".

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:
1. Në paragrafin e dytë, fjalët "për dokumentin e identitetit të shtetasve" zëvendësohen me fjalët "për letërnjoftimin".
2. Paragrafi i katërt shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 26.1.2012

Shpallur me dekretin nr.7267, datë 7.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr. 3/2012

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.5, DATË 28.12.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 418, DATË 21.4.2011 "PËR LEGALIZIMIN E KAPITALIT DHE FALJEN E NJË PJESE TË BORXHIT TATIMOR DHE DOGANOR""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr. 5, datë 28.12.2011 i Këshillit të Ministrave "Për një ndryshim në ligjin nr. 10 418, datë 21.4.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor"".

Miratuar në datën 26.1.2012

Shpallur me dekretin nr.7268, datë 7.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr. 4/2012

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË NDRYSHIMET E KONVENTËS PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË BASHKËPUNIMIT DOGANOR, BËRË NË BRUKSEL MË 15 DHJETOR 1950

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në ndryshimet e konventës për krijimin e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor, bërë në Bruksel më 15 dhjetor 1950.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.2.2012

Shpallur me dekretin nr.7270, datë 14.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

ANEKS 1

REKOMANDIM I KËSHILLIT[1] TË BASHKËPUNIMIT DOGANOR NË LIDHJE ME AMENDIMIN E KONVENTËS QË PËRCAKTON NGRITJEN E KËSHILLIT TË BASHKËPUNIMIT DOGANOR

30 qershor 2007

Këshilli i Bashkëpunimit Doganor,

Duke pranuar rolin gjithnjë e më të rëndësishëm që luajnë Bashkimet Ekonomike apo Doganore në çështjet botërore, dhe veçanërisht në çështje që lidhen me tregtinë,

Duke vërejtur se disa Bashkime Ekonomike apo Doganore janë pjesëmarrës aktivë në punën e organizatës,

Duke pranuar dëshirën legjitime të një Bashkimi Ekonomik apo Doganor që ta vendosë këtë pjesëmarrje mbi një bazë formale duke u bërë Anëtar i Organizatës, dhe mundësinë që të tjerë mund të dëshirojnë të bëjnë këtë në të ardhmen,

Duke pasur parasysh që një Bashkim Doganor apo Ekonomik të bëhet anëtar, duhet bërë një amendim i konventës që përcakton ngritjen e Këshillit të Bashkëpunimit Doganor,

Duke pasur parasysh gjithashtu dispozitat e nenit XX të konventës që përcakton ngritjen e një Këshilli të Bashkëpunimit Doganor në lidhje me amendimin e kësaj konvente,

U rekomandon të gjitha palëve kontraktuese të konventës që përcakton ngritjen e një Këshilli të Bashkëpunimit Doganor, amendimet e mëposhtme të konventës:

Të amendojnë nenin VIII (a) të konventës që do të lexohet si më poshtë:

Neni VIII

a) Me përjashtim të Anëtarëve të Bashkimit Ekonomik apo Doganor, për të cilët Këshilli do të përcaktojë dispozita specifike, çdo anëtar i Këshillit do të ketë një votë, me përjashtim të rastit kur një anëtar nuk do të ketë votë për çështje që lidhen me interpretimin, zbatimin apo amendimin e ndonjë konvente të përmendur në nenin III “d”, që është në fuqi dhe që nuk zbatohet për atë anëtar.

Të shtojnë një nënparagraf “d” në nenin XVIII të konventës, që më pas do të lexohet si më poshtë:

Neni XVIII

a) Qeveria e çdo shteti që nuk është nënshkrues i kësaj konvente, mund të bëhet pjesë e kësaj konvente që nga data 1 prill 1951.

[1] Këshilli i Bashkëpunimit Doganor (KBD) është emri zyrtar i Organizatës Botërore të Doganave.

b) Instrumentet e pranimit do të depozitohen pranë Ministrisë Belge të Punëve të Jashtme, që do të njoftojë të gjitha palët nënshkruese dhe qeveritë që janë anëtare, si dhe Sekretarin e Përgjithshëm për çdo depozitim të tillë.

c) Kjo konventë do të hyjë në fuqi për çdo qeveri që kërkon të bëhet anëtare, me depozitimin e instrumentit të saj të pranimit por jo përpara se të hyjë në fuqi në përputhje me paragrafin "a" të nenit XVII.

d) Çdo Bashkim Ekonomik apo Doganor, në përputhje me paragrafët a, b dhe c më sipër, mund të bëhet Palë Kontraktuese e kësaj konvente. Çdo kërkesë nga Bashkimi Ekonomik apo Doganor që të bëhet palë kontraktuese, i duhet paraqitur fillimisht Këshillit për miratim. Për qëllimet e kësaj konvente "Bashkim Ekonomik apo Doganor" nënkupton një Bashkim të përbërë nga shtete, që ka kompetencë për të bërë rregulloren e vet që janë detyruese për ato shtete në lidhje me çështje që rregullohen nga kjo konventë dhe ka kompetencë të marrë vendime në përputhje me procedurat e veta të brendshme, për t'u bërë palë e kësaj konvente.

U kërkon palëve kontraktuese të konventës që përcakton ngritjen e një Këshilli të Bashkëpunimit Doganor, që pranojnë këtë rekomandim, të njoftojnë me shkrim për miratimin e tyre Ministrinë Belge të Punëve të Jashtme.

ANEKS 2
ESKTRAKT NGA KONVENTA QË PËRCAKTON NGRITJEN E NJË KËSHILLI TË BASHKËPUNIMIT DOGANOR

Neni XX

"…

a) Këshilli mund t'u rekomandojë Palëve Kontraktuese amendime për këtë konventë.

b) Çdo Palë Kontraktuese që pranon një amendim do të njoftojë me shkrim për miratimin e saj Ministrinë Belge të Punëve të Jashtme, dhe Ministria Belge e Punëve të Jashtme do të njoftojë të gjitha palët nënshkruese dhe qeveritë që janë anëtare, si dhe Sekretarin e Përgjithshëm, për marrjen e njoftimit të pranimit.

c) Një amendim do të hyjë në fuqi tre muaj pasi Ministria Belge e Punëve të Jashtme të ketë marrë njoftimin e miratimit nga të gjitha palët kontraktuese. Kur një amendim është pranuar nga të gjitha palët kontraktuese, Ministria Belge e Punëve të Jashtme do të njoftojë të gjitha palët nënshkruese dhe qeveritë që janë anëtare, si dhe Sekretarin e Përgjithshëm, për miratimin e amendimit, si dhe datën kur amendimi hyn në fuqi.

d) Pas hyrjes në fuqi të çdo amendimi, asnjë qeveri nuk mund të ratifikojë apo të bëhet palë e kësaj konvente, nëse nuk pranon edhe amendimin.

ANEKS 3
MODEL

NJOFTIM PËR PRANIMIN E AMENDIMEVE TË KONVENTËS QË PËRCAKTON NGRITJEN E NJË KËSHILLI TË BASHKËPUNIMIT DOGANOR
(LIDHUR NË BRUKSEL MË 15 DHJETOR 1950)
REKOMANDUAR NGA KËSHILLI NË SESIONET E 109/110-TË NË QERSHOR 2007

Ndërsa qeveria e ..... është një palë kontraktuese e konventës që përcakton ngritjen e një Këshilli të Bashkëpunimit Doganor, lidhur në Bruksel më 15 dhjetor, një mijë e nëntëqind e pesëdhjetë;

Ndërsa më 13 qershor, dy mijë e shtatë, Këshilli u rekomandoi palëve kontraktuese disa amendime të nenit VIII dhe nenit XVIII të konventës në fjalë;

Dhe ndërsa, neni XX i konventës në fjalë kërkon që çdo palë kontraktuese që pranon një amendim do të njoftojë me shkrim për pranimin e saj Ministrinë Belge të Punëve të Jashtme;

Tashmë, për rrjedhojë qeveria e ....., pasi shqyrtoi dhe miratoi amendimet e nenit VIII dhe nenit XVIII të konventës në fjalë, që u rekomanduan nga Këshilli, pranon zyrtarisht këto amendime.

Në dëshmi të kësaj, unë.....(emri)
Ministër për.....
kam nënshkruar këtë njoftim pranimi dhe kam vënë vulën e zyrës sime.

(Vula) .....nënshkrimi
(Vendi).....më.....20.....

LIGJ
Nr. 5/2012

PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT TË PRIVILEGJEVE DHE IMUNITETEVE TË QENDRËS PËR ZBATIMIN E LIGJIT NË EUROPËN JUGLINDORE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet protokolli i privilegjeve dhe imuniteteve të Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.2.2012

Shpallur me dekretin nr.7271, datë 14.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

PROTOKOLLI
MBI PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E QENDRËS PËR ZBATIMIN E LIGJIT NË EUROPËN JUGLINDORE

Palët e këtij Protokolli, duke pasur parasysh se konventa e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore, bërë në Bukuresht, Rumani më 9 dhjetor 2009, parashikon që shtetet anëtare të lidhin një protokoll mbi privilegjet dhe imunitetet e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore,

kanë rënë dakord si më poshtë:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Përkufizime

Për qëllime të këtij Protokolli:

a) "Konventa e SELEC" nënkupton konventën e Qendrës për Zbatimin e Ligjit në Europën Juglindore, bërë në Bukuresht, Rumani, më 9 dhjetor 2009;

b) "SELEC" nënkupton Qendrën e Zbatimit të Ligjit në Europën Juglindore;

c) "Vendi pritës" nënkupton vendin ku ndodhet selia e SELEC;

d) "Përfaqësuesit e Shteteve Anëtare" nënkupton anëtarët e delegacioneve shtetërore që marrin pjesë në mbledhjet e thirrura nga SELEC;

e) "Stafi i SELEC" nënkupton të gjithë personat që punojnë nën drejtimin dhe kontrollin e Drejtorit të Përgjithshëm dhe drejtorëve të tjerë;

f) "Drejtori i Përgjithshëm" nënkupton Drejtorin e Përgjithshëm të SELEC;

g) "Drejtorët" nënkupton drejtorët e tjerë të SELEC;

h) "Koordinatorët" nënkupton punonjësit e emëruar në zyrat e SELEC nga shtetet anëtare;

i) "Mbledhje e thirrur nga SELEC" nënkupton çdo mbledhje të çdo organi të SELEC ose organi në varësi apo çdo konferencë të thirrur nga SELEC;

j) "Pronë" nënkupton të gjitha të ardhurat e SELEC dhe të gjitha pronat e saj, duke përfshirë fondet, asetet dhe pasuritë e tjera që i takojnë SELEC, qoftë ato në pronësi të SELEC apo në administrim apo që mbahen nga SELEC në përputhje me detyrat zyrtare të kryera nga SELEC;

k) "Ambientet" nënkupton godinat ose pjesë të godinave, duke përfshirë truallin në vartësi të tyre që shfrytëzohen vetëm për qëllim të SELEC, pavarësisht pronësisë së tyre;

l) "Arkivat" nënkupton të gjitha dosjet, raportet, korrespondencën, dokumentet, dorëshkrimet, informacione kompjuterike dhe mediatike, fotografi, filma, video, regjistrime zanore dhe çdo të dhënë tjetër që i takon apo mbahet nga SELEC.

Neni 2
Zbatimi i Protokollit

SELEC do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet përkatëse të palëve për të lehtësuar administrimin e duhur të drejtësisë dhe parandalon çdo abuzim me privilegjet dhe imunitetet e dhëna sipas dispozitave të këtij protokolli.

KREU II
PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E SELEC

Neni 3
Imuniteti ndaj një procesi ligjor

1. SELEC dhe pronat e saj, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, gëzojnë imunitet ndaj çdo forme procesi ligjor me përjashtim të ndonjë rasti të veçantë kur Këshilli, me vendim të tij autorizon heqjen e këtij imuniteti. Asnjë heqje e tillë e imunitetit nuk do të shtrihet në ndonjë masë ekzekutimi për të cilën do të jetë e nevojshme një heqje e veçantë e imunitetit.

2. Pa cenuar paragrafin e mësipërm, SELEC nuk do të gëzojë imunitet në lidhje me:

a) një padi civile në bazë të një detyrimi kontraktual të SELEC;

b) një kundërpadi të lidhur drejtpërdrejt me procedimet ligjore të filluara nga SELEC;

c) një padi civile në lidhje me shkelje të rregullave për mbrojtjen e të dhënave personale që përcaktohen në Konventën e SELEC;

d) një padi civile për dëmet e rezultuara nga një aksident i shkaktuar nga një automjet, anije apo avion që i përket ose që operon në emër të SELEC kur këto dëme nuk mbulohen nga sigurimet.

Neni 4
Paprekshmëria

1. Ambientet e SELEC janë të paprekshme. Pronat e saj, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, kanë imunitet nga çdo kontroll, kërkesë, konfiskim, shpronësim apo çdo formë tjetër ndërhyrjeje, qofshin akte ekzekutive, administrative, gjyqësore apo legjislative.

2. Arkivat e SELEC janë të paprekshme kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen.

Neni 5
Flamuri dhe emblema

SELEC ka të drejtë të ekspozojë flamurin dhe emblemën e saj në ambientet e veta dhe në mjetet e saj të transportit kur përdoren për qëllime zyrtare. Flamujt e vendeve anëtare vendosen në ambientet e SELEC.

Neni 6
Lehtësirat dhe imunitetet në lidhje me komunikimet dhe publikimet

1. Palët lejojnë SELEC të komunikojnë lirisht dhe pa nevojën për të marrë leje të veçantë për të gjitha qëllimet zyrtare, dhe mbrojnë të drejtat e SELEC për të vepruar kështu. SELEC ka të

drejtë të përdorë sisteme të fshehta, si edhe kode të ndryshme për të dërguar dhe marrë korrespondencat zyrtare dhe komunikimet e tjera zyrtare nëpërmjet korrierëve apo në çanta të vulosura, të cilat i nënshtrohen të njëjtave privilegje dhe imunitete si ato për korrierët dhe çantat diplomatike.

2. SELEC, për komunikimet e saj zyrtare, gëzon trajtim jo më pak të favorshëm se ai i akorduar nga palët për misionet diplomatike të çdo shteti.

3. Palët njohin të drejtën e SELEC për të publikuar brenda territorit të tyre për qëllimet e përcaktuara në konventën e SELEC. Të gjitha komunikimet zyrtare të drejtuara për SELEC dhe të gjitha njoftimet zyrtare të jashtme të lëshuara nga SELEC, të transmetuara nëpërmjet çdo forme e mjeti, janë të paprekshme.

Neni 7
Përjashtime

1. Brenda objektit të veprimtarisë së saj zyrtare, SELEC dhe pronat e saj përjashtohen nga:

a) të gjitha taksat direkte të vendosura nga autoritetet kombëtare, rajonale apo lokale; por ka një mirëkuptim që SELEC nuk do të kërkojë të përjashtohet nga tarifat, taksat apo pagesat të cilat nuk janë gjë tjetër veç detyrimet për shërbimet e ndryshme publike e komunale;

b) taksat doganore, ndalimet apo kufizimet në importin apo eksportin e mallrave për përdorim zyrtar, me kusht që mallrat e importuara të mos shiten apo disponohen ndryshe në territorin e palës në fjalë, me përjashtimet sipas kushteve të miratuara nga ajo palë;

c) taksat doganore, ndalimet apo kufizimet për importin apo eksportin e publikimeve për qëllime zyrtare;

d) taksimet indirekte për mallrat dhe shërbimet e siguruara për qëllime zyrtare, duke përfshirë TVSH-në mbi këto mallra dhe shërbime, sipas të njëtjave kushte që aplikohen për misionet diplomatike në territorin e palës në fjalë.

2. Përjashtimet e parashikuara në paragrafin 1, pika “d” e këtij neni mund të jepen nëpërmjet një kompensimi sipas procedurave të njëjta që aplikohen për misionet diplomatike në territorin e palës në fjalë.

Neni 8
Lirimi i aseteve financiare nga kufizimet

Duke mos qenë objekt i asnjë kontrolli financiar apo moratoriumi të çfarëdo lloji, brenda territorit të palëve, SELEC është i lirë:

a) të blejë nëpërmjet kanaleve të autorizuara çdo monedhë dhe t’i mbajë ose t’i shesë ato;

b) të operojë llogari bankare në çdo monedhë.

KREU III
PRIVILEGJET DHE IMUNITETET E PERSONAVE TË ANGAZHUAR ME PUNË NË SELEC

Neni 9
Privilegjet dhe imunitetet e përfaqësuesve të shteteve anëtare

1. Përfaqësuesit e shteteve anëtare, gjatë kohës së ushtrimit të misionit të tyre në SELEC dhe gjatë udhëtimeve të tyre për dhe nga vendet e mbledhjeve të organizuara nga SELEC, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet e mëposhtme:

a) imunitetin ndaj arrestimit apo ndalimit të personit dhe sekuestrimit të bagazheve të tyre personale;

b) imunitetin ndaj çdo lloj procesi ligjor në lidhje me fjalët e shprehura apo të shkruara dhe për të gjitha veprimet e kryera nga ata në cilësinë e tyre si përfaqësues; ky imunitet do të vazhdojë të akordohet pavarësisht se personat në fjalë mund të kenë pushuar ushtrimin e funksioneve të tyre si përfaqësues;

c) paprekshmërinë e dokumentacionit zyrtar, informacioneve dhe materialeve të tjera zyrtare në zotërim të tyre;

d) të drejtën për të përdorur kode dhe për të marrë dokumente e korrespondenca me korrier apo në çanta të vulosura;

e) përjashtimi i vetë atyre dhe i bashkëshortëve nga kufizimet e emigracionit dhe formaliteteve për regjistrimin e shtetasve të huaj në vendin e palës që vizitojnë apo kalojnë transit për ushtrimin e funksioneve të tyre;

f) të njëjtat lehtësira në lidhje me monedhat apo kufizimet në konvertimin e tyre, siç u akordohen përfaqësuesve të qeverive të huaja në misionet e tyre zyrtare të përkohshme;

g) të njëjtat imunitete dhe lehtësira në lidhje me bagazhet e tyre personale siç u akordohen agjentëve diplomatikë.

2. Paragrafi 1 i këtij neni nuk do të aplikohet ndërmjet një përfaqësuesi dhe shtetit anëtar nga i cili ai/ajo është shtetas apo rezident i përhershëm apo ai/ajo është ose ka qenë përfaqësues.

Neni 10

Privilegjet dhe imunitetet e koordinatorëve

1. Në vendet pritëse, koordinatorëve dhe anëtarëve të familjeve të tyre që janë pjesë e këtyre familjeve, u akordohen privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet dhe lehtësirat që u akordohen agjentëve diplomatikë dhe anëtarëve të familjeve të tyre në përputhje me konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike të datës 18 prill 1961.

2. Koordinatorët nuk angazhohen në asnjë veprimtari fitimprurëse në vendet pritëse përveç atyre që rezultojnë nga funksionet e tyre në SELEC.

3. Koordinatorët që janë shtetas apo rezidentë të përhershëm në vendin pritës gëzojnë imunitet ndaj çdo procesi ligjor dhe janë të paprekshëm vetëm në lidhje me veprimet zyrtare që kryhen gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

4. Në territorin e palëve, veç vendit pritës, koordinatorët, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre të lidhur me punën në SELEC, gëzojnë privilegjet dhe imunitetet që aplikohen për përfaqësuesit e shteteve anëtare siç përcaktohet në nenin 9, me përjashtim të pikave e dhe g të nenit 9, paragrafi 1.

Neni 11

Privilegjet dhe imunitetet e Drejtorit të Përgjithshëm, drejtorëve dhe stafit të SELEC

1. Drejtori i Përgjithshëm, drejtorët dhe stafi i SELEC:

a) do të jenë të imunizuar nga çdo proces ligjor edhe pas përfundimit të punës së tyre në SELEC në lidhje me fjalët e shprehura ose të shkruara dhe për të gjitha veprimet e kryera nga ta në funksionet e tyre zyrtare dhe brenda kufijve të kompetencave të tyre;

b) do të përjashtohen nga taksimi i rrogave, shpërblimeve dhe pagesave që SELEC u bën atyre;

c) do të përjashtohen bashkë me anëtarët e familjeve të tyre që përbëjnë këto familje nga kufizimet e emigracionit dhe formalitetet për regjistrimin e shtetasve të huaj;

d) do t'u akordohen të njëjtat lehtësira në lidhje me monedhat dhe kufizimet në konvertimin e tyre siç u akordohen anëtarëve në nivele të krahasueshme me ato të misioneve diplomatike;

e) do t'u jepen, bashkë me anëtarët e familjeve të tyre që përbëjnë këto familje të njëjtat lehtësira riatdhesimi në kohën e krizave ndërkombëtare, siç u akordohen anëtarëve të nivelit të krahasueshëm të misioneve diplomatike;

f) do të kenë të drejtë, në vendin pritës, në përputhje me ligjet dhe rregullat e tij, për të importuar pa taksa doganore mobiljet dhe sendet e tyre personale, duke përfshirë një automjet, në kohën kur fillojnë për herë të parë punën në postin e caktuar dhe kanë të drejtë t'i eksportojnë ato pa taksa doganore kur përfundojnë funksionin e tyre në SELEC;

g) nuk do të jenë të detyruar të japin të dhëna si dëshmitarë në lidhje me detyrat e tyre zyrtare;

dhe

h) do të gëzojnë paprekshmëri për të gjitha shkresat, dokumentacionin dhe materialet e tjera zyrtare në lidhje me SELEC.

2. Përveç privilegjeve dhe imuniteteve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorëve të tjerë iu akordohen në vendin pritës, vetë atyre dhe anëtarëve të familjeve të tyre që përbëjnë këto familje, privilegjet dhe imunitetet, përjashtimet dhe lehtësira që iu akordohen agjentëve diplomatikë dhe anëtarëve të familjeve të tyre në përputhje me Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike, të datës 18 prill 1961.

3. Privilegjet dhe imunitetet e Drejtorit të Përgjithshëm, drejtorëve të tjerë dhe stafit të SELEC të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, pikat "b" deri te "f" dhe në paragrafin 2 të këtij neni, nuk do të aplikohen në lidhje me palën nga e cila personi është shtetas apo rezident i përhershëm.

Neni 12

Privilegjet dhe imunitetet e përfaqësuesve të partnerëve operacionalë

Përfaqësuesit e partnerëve operacionalë, që vendosen në SELEC në bazë të një marrëveshjeje bashkëpunimi, u akordohen privilegje dhe imunitete siç u akordohen koordinatorëve të shteteve anëtare në atë masë që këto privilegje dhe imunitete kufizohen në marrëveshjet e bashkëpunimit të lidhura ndërmjet partnerëve operacionalë dhe SELEC.

Neni 13

Njoftimet

1. Secila palë i njofton Drejtorit të Përgjithshëm dhe depozitarit, emrat dhe pozicionet/funksionet e përfaqësuesve të saj dhe të koordinatorëve, si dhe anëtarët e familjes së koordinatorëve që janë anëtarë të familjes.

2. Secili partner operacional i njofton Drejtorit të Përgjithshëm dhe depozitarit emrat e përfaqësuesve të tij.

3. Drejtori i Përgjithshëm përcakton në një listë të përditësuar, që i komunikohet secilës palë, emrat dhe funksionet e personave të renditura më poshtë:

a) Drejtori i Përgjithshëm;

b) Drejtorët;

c) Anëtarët e stafit të SELEC;

d) Koordinatorët; dhe

e) Përfaqësuesit e partnerëve operacionalë.

Neni 14
Hyrja, qëndrimi, largimi dhe transiti

Palët krijojnë lehtësira, kur është e nevojshme, për hyrjen dhe qëndrimin në territorin e një pale dhe nuk krijojnë asnjë pengesë për largimin nga ajo palë të personave të renditur më poshtë kur kjo hyrje apo ky qëndrim lidhet me aktivitete zyrtare të SELEC dhe merr masa që atyre të mos u krijohet asnjë pengesë gjatë kalimit transit për ose nga vendi ku ata kanë një punë zyrtare të lidhur me SELEC:

a) Përfaqësuesit e shteteve anëtare;
b) koordinatorët; dhe
c) Drejtori i Përgjithshëm, drejtorët dhe stafi i SELEC.

Neni 15
Kohëzgjatja e privilegjeve dhe imuniteteve

1. Në territorin e vendit pritës, çdo person që ka të drejtën e privilegjeve dhe imuniteteve në përputhje me këtë titull do t'i gëzojë këto privilegje dhe imunitete nga momenti kur ai/ajo hyn në vendin pritës për të kryer procedurat e marrjes së detyrës së saj/tij, ose, nëse ndodhet aktualisht në vendin pritës, nga momenti kur autoritetet kompetente të vendit pritës njoftohen për mbërritjen e tij/saj nga pala dërguese. Kur këta persona e përfundojnë detyrën e tyre, privilegjet dhe imunitetet që ata gëzojnë në vendin pritës normalisht ndërpriten në momentin kur ata largohen nga vendi pritës, ose me skadimin e një afati të arsyeshëm për ta bërë këtë. Megjithatë, në lidhje me veprimet e kryera nga këta persona në ushtrimin e funksioneve të tyre, imuniteti do të vazhdojë të veprojë.

2. Gjatë ushtrimit të punës zyrtare të saj/tij në lidhje me SELEC në territorin e palëve përveç vendit pritës, çdo person që ka të drejtën e privilegjeve dhe imuniteteve në përputhje me këtë të drejtë do të gëzojë këto privilegje dhe imunitete nga momenti kur ai/ajo hyn në territorin e palës në fjalë dhe gjatë qëndrimit të tij/saj në territorin e kësaj pale. Megjithatë, kuptohet se asgjë në këtë protokoll nuk do të pengojë autoritetet përkatëse të palëve të kërkojnë të dhëna të arsyeshme nga SELEC ku të konfirmohet se personat që pretendojnë trajtimin e përcaktuar në këtë protokoll po udhëtojnë për punë zyrtare të SELEC.

Neni 16
Kufizimi i imuniteteve

Imuniteti ndaj proceseve ligjore nuk aplikohet në lidhje me një padi civile për dëmet e rezultuara nga një aksident në territorin e një pale të shkaktuar nga një automjet, anije ose avion që përdoret nga çdo përfaqësues i një shteti anëtar, nga koordinatorët, drejtori i përgjithshëm, drejtorët, anëtarët e stafit të SELEC, ose përfaqësuesit e një partneri operacional, dhe as imuniteti nga një proces ligjor nuk aplikohet në lidhje me një shkelje të rregullave të trafikut.

Neni 17
Heqja e imuniteteve

1. Privilegjet dhe imunitetet në këtë protokoll akordohen jo për përfitime personale të vetë personave, por me qëllim që të sigurohet ushtrimi i pavarur i funksioneve të tyre në lidhje me SELEC.

2. Pa cenuar privilegjet dhe imunitetet e tyre, është detyrë e të gjithë personave që gëzojnë privilegje dhe imunitete të tilla në përputhje me këtë protokoll, të respektojnë ligjet dhe rregullat e vendit pritës dhe të palëve të tjera.

3. Kompetencat për heqjen e imunitetit janë si më poshtë:

a) në lidhje me përfaqësuesit dhe koordinatorët e shteteve anëtare, heqja e imunitetit do të jetë në kompetencë të palës dërguese. Kjo palë do të ketë të drejtë dhe detyrë të heqë imunitetin në rastet kur, sipas mendimit të saj, imuniteti do të pengonte rrjedhën e drejtësisë dhe nuk do të cenonte qëllimet për të cilat është dhënë imuniteti;

b) në lidhje me Drejtorin e Përgjithshëm dhe drejtorët, Këshilli do të ketë të drejtën dhe detyrën të heqë imunitetin kur imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesat e SELEC;

c) në lidhje me ndonjë anëtar të stafit të SELEC, Drejtori i Përgjithshëm do të ketë të drejtën dhe detyrën për heqjen e imunitetit kur imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe mund të hiqet pa cenuar interesat e SELEC;

d) në lidhje me përfaqësuesit e një partneri operacional, heqja e imunitetit do të jetë në kompetencë të partnerit operacional dërgues. Ky partner operacional ka të drejtën dhe detyrën të heqë imunitetin në rastet kur, sipas mendimit të tij, imuniteti do të pengonte rrugën e drejtësisë dhe nuk do të cenonte qëllimet për të cilat është dhënë imuniteti.

4. Asnjë heqje e tillë imuniteti nuk shtrihet te ndonjë masë ekzekutimi për të cilën është e nevojshme heqje imuniteti e veçantë.

5. SELEC do të bashkëpunojë në çdo kohë me autoritetet kompetente të palëve dhe të partnerëve operacionalë, me qëllim që të lehtësojë administrimin e duhur të drejtësisë dhe të parandalojë çdo abuzim me privilegjet dhe imunitetet e dhëna në bazë të dispozitave të këtij protokolli.

KREU IV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 18
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim nga shtetet nënshkruese në Konventën e SELEC.

2. Ky protokoll është subjekt ratifikimi, pranimi apo miratimi nga shtetet nënshkruese në përputhje me kërkesat ligjore përkatëse.

3. Pas hyrjes së saj në fuqi, çdo palë tjetër në Konventën e SELEC mund të aderojë në këtë protokoll.

4. Dokumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit depozitohen te depozitari.

Neni 19
Rezervat

Këtij protokolli nuk mund t'i bëhet asnjë rezervë.

Neni 20
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e protokollit

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi gjashtëdhjetë ditë pas datës kur nëntë shtete nënshkruese të kenë depozituar dokumentet e ratifikimit, pranimit ose miratimit.

2. Për çdo shtet që ratifikon, pranon, miraton ose aderon në këtë protokoll pas datës së hyrjes së tij në fuqi, ky protokoll do të hyjë në fuqi në datën e depozitimit nga ai shtet të instrumenteve përkatëse.

3. Ky protokoll do të mbetet në fuqi për aq kohë sa të jetë në fuqi Konventa e SELEC.

Neni 21
Ndryshimet

1. Ky protokoll mund të ndryshohet me propozim të çdo pale.

2. Çdo propozim i tillë u komunikohet palëve nga Drejtori i Përgjithshëm të paktën gjashtë muaj para dorëzimit të tij në Këshill për shqyrtim dhe miratim.

3. Ndryshimet e këtij protokolli të miratuara në përputhje me paragrafin 2 të mësipërm janë subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi nga palët dhe hyjnë në fuqi sipas procedurave të përcaktuara në nenin 20.

Neni 22
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve ose ndërmjet një pale dhe SELEC në lidhje me interpretimin ose zbatimin e këtij protokolli, palët e interesuara do të përpiqen t'i zgjidhin nëpërmjet konsultimeve dhe bisedimeve të ndërsjella. Nëse këto konsultime dhe bisedime nuk arrijnë të zgjidhin mosmarrëveshjen brenda gjashtë muajve, palët do t'ia paraqesin çështjen Këshillit për shqyrtim dhe veprimet e nevojshme.

Neni 23
Tërheqja

1. Çdo palë mund të tërhiqet nga ky protokoll në çdo kohë me anë të një njoftimi me shkrim dërguar sekretariatit të SELEC dhe depozitarit, i cili më pas i dërgon një kopje të vërtetuar të këtij njoftimi secilës palë.

2. Çdo palë që tërhiqet nga konventa e SELEC në bazë të procedurave të përcaktura në nenin 51 të kësaj Konvente, tërhiqet në të njëjtën kohë nga ky protokoll.

3. Tërheqja bëhet e vlefshme tre muaj pas datës në të cilën depozitari merr njoftimin.

Neni 24
Depozitari

1. Qeveria e Rumanisë vepron si depozitari i këtij protokolli.

2. Depozitari i dërgon një kopje të vërtetuar me origjinalin Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Origjinali i këtij protokolli, në një kopje të vetme në gjuhën angleze, depozitohet te depozitari, i cili i dërgon secilës palë një kopje të vërtetuar.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në _____më_____

LIGJ
Nr. 6/2012

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.10 129, DATË 11.5.2009
"PËR GJENDJEN CIVILE"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në ligjin nr. 10 129, datë 11.5.2009 "Për gjendjen civile", fjalët "numri i identitetit" zëvendësohen me fjalët "numri personal".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 2.2.2012

Shpallur me dekretin nr.7272, datë 14.2.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM
Nr. 1/2012

PËR NUMËRTIMIN E LIGJEVE DHE VENDIMEVE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kryetares së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Duke filluar prej datës 26 janar 2012, numërtimi i ligjeve dhe vendimeve që miratohen në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të bëhet sipas strukturës së mëposhtme:

"LIGJ
Nr. 1/2012 "PËR…"
"LIGJ
Nr. 2/2012 "PËR…"

II. Në përfundim të procedurës së miratimit të projektligjit apo projektvendimit në seancë plenare, pas nenit të hyrjes në fuqi të tij të shënohet: "Miratuar në: (data, muaji, viti)".

III. Me mbarimin e vitit kalendarik, administrata e Kuvendit vendos numërtimin duke filluar prej numrit 1 dhe duke vijuar me vitin kalendarik, sipas pikës I të këtij vendimi.

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 26.1.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.2/2012

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR DHE CAKTIMIN E OBJEKTIT, PËRBËRJES DHE AFATIT TË KOMISIONIT HETIMOR PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR NISJEN E PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË ZOTIT KRESHNIK SPAHIU, ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Në mbështetje të nenit 147 pika 1 të Kushtetutës, vendimit nr.75, datë 19.4.2002 të Gjykatës Kushtetuese dhe nenit 114 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh për "Nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të zotit Kreshnik Spahiu, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë".

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt dhe detyrë të verifikojë të dhënat, faktet dhe rrethanat për aktet dhe sjelljet që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e postit të lartë kushtetues të anëtarit dhe Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe që përbëjnë shkak ligjor për shkarkimin e tij nga detyra.

III. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, 5 nga shumica parlamentare dhe 4 nga opozita. Kryetari i Komisionit i takon grupimit nismëtar të deputetëve.

IV. Komisioni përbëhet nga:

1. Enkelejd Alibeaj	Kryetar	PD
2. Paulina Hoti	Anëtar	"
3. Ramiz Çobaj	"	"
4. Ledina Aliolli	"	"
5. Gerti Bogdani	"	PD
6._____	"	PS
7._____	"	"
8._____	"	"
9._____	"	"

V. Komisioni do ta zhvillojë veprimtarinë e tij brenda afatit 3-javor nga data e miratimit të këtij vendimi.

VI. Ngarkohen Kryetarja e Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë e këtij Komisioni.

VII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 26.1.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 3/2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KUVENDIT NR.3, DATË 16.9.2009 "PËR CAKTIMIN E PËRBËRJES SË KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 78 pika 1 të Kushtetutës, të neneve 55 pika 1 dhe 21 pikat 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Konferencës së Kryetarëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në vendimin e Kuvendit nr. 3, datë 16.9.2009 "Për caktimin e përbërjes së komisioneve të përhershme të Kuvendit", të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

I. Deputeti Kastriot Islami largohet nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe caktohet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 26.1.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 4/2012

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR FILLIMIN E NDJEKJES PENALE NDAJ DEPUTETIT TAULANT BALLA

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 73 pikat 2 dhe 4 të Kushtetutës dhe të nenit 118 pika 4 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

I. Dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Taulant Balla, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 2.2.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 5/2012

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR FILLIMIN E NDJEKJES PENALE NDAJ DEPUTETIT TOM DOSHI

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 73 pikat 2 dhe 4 të Kushtetutës dhe të nenit 118 pika 4 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Tom Doshi, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 2.2.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 6/2012

PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR FILLIMIN E NDJEKJES PENALE NDAJ DEPUTETIT BESNIK BARAJ

Në mbështetje të neneve 78 pika 1, 73 pikat 2 dhe 4 të Kushtetutës dhe të nenit 118 pika 4 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Dhënien e autorizimit për fillimin e ndjekjes penale ndaj deputetit Besnik Baraj, kërkuar nga Prokurori i Përgjithshëm.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 2.2.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 7/2012

PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE ORGANIKËS SË AUTORITETIT TË KONKURRENCËS

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 "Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", të ndryshuar, me propozimin e Autoritetit të Konkurrencës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet struktura e Autoritetit të Konkurrencës, sipas lidhjes nr.1 bashkëlidhur.
II. Miratohet organika e Autoritetit të Konkurrencës, sipas lidhjes nr.2 bashkëlidhur.
III. Vendimi i Kuvendit nr.182, datë 12.5.2008 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Autoritetit të Konkurrencës", shfuqizohet.
IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 2.2.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Lidhja nr. 1

STRUKTURA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS



Lidhja nr. 2

ORGANIKA E AUTORITETIT TË KONKURRENCËS
E SHOQËRUAR ME KATEGORIZIMET E PAGËS PËR ÇDO POZICION

POZICIONI		**NUMRI**
I. KRYETAR		**(1)**
II. KOMISIONER		**(4)**
III. KABINETI		**(3)**
Drejtor kabineti		1
Këshilltar		1
Sekretare		1
IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM		**(1)**
V. *Sektori i Analizës dhe Studimeve*		**(3)**
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	1
Specialist (IT)	III-b	1
VI. DREJTORIA E MBIKËQYRJES DHE HETIMIT TË TREGJEVE		**(10)**
Drejtor		1
Sektori i Pozitës Dominuese		
Inspektor	III-a	3
Sektori Anti-Kartel		
Inspektor	III-a	3
Sektori i Përqendrimeve		
Inspektor	III-a	3
VII. DREJTORIA JURIDIKE, HETIMIT DHE PROCEDURAVE		**(5)**
Drejtor		1
Inspektor		4

POZICIONI		NUMRI
VIII. DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE INTEGRIMIT EUROPIAN		**(8)**
Drejtor	II-b	1
Sektori i Përafrimit të legjislacionit dhe procedurat		**(3)**
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist	III-b	2
Sektori i Burimeve Njerëzore, Buxhetit, Shërbimeve dhe Dokumentacionit		**(4)**
Përgjegjës sektori	III-a	1
Specialist buxheti	III-b	1
Specialist (arkiv-dokumentacion)	IV-b	1
Punonjëse pastrimi		1
GJITHSEJ		**35 veta**

VENDIM
Nr. 8/2012

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË (ERE)

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Adriatik Bego emërohet anëtar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 2.2.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 9/2012

PËR SHTYRJEN E AFATIT TË VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT "PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR DHE CAKTIMIN E OBJEKTIT, PËRBËRJES DHE AFATIT TË KOMISIONIT HETIMOR PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR NISJEN E PROCEDURËS SË SHKARKIMIT NGA DETYRA TË ZOTIT KRESHNIK SPAHIU, ZËVENDËSKRYETAR I KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË", TË NGRITUR ME VENDIMIN E KUVENDIT NR. 2/2012, DATË 26.1.2012

Në mbështetje të neneve 77 dhe 78 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e komisionit hetimor të Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Afati i veprimtarisë së komisionit hetimor të Kuvendit "Për ngritjen e komisionit hetimor dhe caktimin e objektit, përbërjes dhe afatit të komisionit hetimor për shqyrtimin e kërkesës për nisjen e procedurës së shkarkimit nga detyra të zotit Kreshnik Spahiu, Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë", të ngritur me vendimin e Kuvendit nr. 2/2012, datë 26.1.2012, zgjatet për një periudhë 2-javore, duke filluar nga data e miratimit të këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 16.2.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 10/2012

PËR LIRIMIN E ZONJËS ENKELEDA SHEHI NGA DETYRA E NËNKRYETARIT TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE NË POZICIONIN DREJTUES I DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES DHE DISIPLINIMIT DHE ZGJEDHJEN E SAJ NË DETYRËN E KRYETARIT TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 6 dhe 8 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zonja Enkeleda Shehi lirohet nga detyra e Nënkryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në pozicionin drejtues i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit.

II. Zonja Enkeleda Shehi zgjidhet në detyrën e Kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 16.2.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr. 11/2012

PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT MATI PEPA ANËTAR TË BORDIT TË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE NË POZICIONIN NËNKRYETAR, DREJTUES I DEPARTAMENTIT TË MBIKËQYRJES DHE DISIPLINIMIT

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", si dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Mati Pepa zgjidhet anëtar i Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në pozicionin Nënkryetar, drejtues i Departamentit të Mbikëqyrjes dhe Disiplinimit, në vend të zonjës Enkeleda Shehi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 16.2.2012

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 20.2.2012
Doli nga shtypi më 21.2.2012

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 32 lekë